Kronikë

Të shtëna me armë gjatë operacionit të policisë në Laç! Plagoset një person, detajet

Një aksion i forcave Operacionale të Drejtorisë së Policisë Vendore të Lezhës në zonën e Kurbinit është shoqëruar me të shtëna me arme zjarri dhe plagosjen e një personi. Ngjarja ka ndodhur gjatë natës në qytetin e Laçit, ku sipas burimeve policia kishte shkuar për të prangosur një të ri dhe në ato momente është qëlluar me armë zjarri.

Foto ilustruese

Elvis Hila
13 Mars, 08:00 | **Përditësimi: 13 Mars, 16:09**

Share

KURBIN- Një aksion i forcave Operacionale të Drejtorisë së Policisë Vendore të Lezhës në zonën e Kurbinit është shoqëruar me të shtëna me armë zjarri dhe plagosjen e një personi.

Ngjarja ka ndodhur gjatë natës në qytetin e Laçit, ku sipas burimeve policia kishte shkuar për të prangosur një të ri dhe në ato momente është qëlluar me armë zjarri.

Sipas njoftimit zyrtar të Policisë blutë kishin marrë informacion se shtetasi i kërkuar po lëvizte me automjet, në lagjen nr. 4, Laç.

Sh.com

LEXO EDHE:
Qarku i Lezhës/ Manja kryeson garën e PS, 2 emra në listën e mbyllur dhe 7 në atë të hapur, 4 janë gra! Një kandidat edhe nga Diaspora, më i riu vetëm 26 vjeç

Në momentin e ndërhyrjes për ndalimin e të riut, blutë kanë dëgjuar të shtëna me armë zjarri, dhe menjëherë kanë ndërhyrë ku u vunë në ndjekje të automjetit që lëvizi me shpejtësi, sapo u konstatuan shërbimet e Policisë.

Gjatë ndjekjes, automjeti që drejtohej nga 28-vjeçari në kërkim, në tentativë për t'iu shmangur shërbimeve, është përplasur me automjetin e shërbimeve operacionale të policisë, por blutë kanë arritur të neutralizojnë dhe arrestojnë Klaudio Buraku, banues në Laç.

Gjatë kontrollit, Policia gjeti dhe sekuestroi 3 armë zjarri (2 pistoleta dhe 1 kallashnikov) dhe municion luftarak. 28-vjeçari ishte shpallur në kërkim në vitin 2023, për armëmbajtje pa leje, kanosje dhe shkatërrim të pronës, ndërsa nga veprimet hetimore të kryera në vendngjarje, dyshohet se para se të ndërhynte Policia, në automjetin e tij ndodheshin dhe persona të tjerë.

Autori i dyshuar i plagosjes që ndodhi mbrëmjen e kaluar në Lezhë, është vënë në pranga.

68-vjeçari Gjin Buzuku qëlloi me armë zjarri 26-vjeçarin Mehmet Domi.

Ngjarja ndodhi në lagjen numër 4 në Kurbin, në kohën kur Operacionalja pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Vendore të Lezhës ka qenë duke kryer një operacion për kapjen e nipit të 68-vjeçarit, 28-vjeçarin Klaudio Burakun, i cili që prej vitit 2023 ishte shpallur në kërkim për armëmbajtje pa leje, kanosje dhe shkatërrim prone.

R.D/A.Q/Shqiptarja.com

TAG: Kurbin | Lezhe | plagosje me arme zjarri | Gjim Buraku | Klaudio Buraku | Mehmet Domi

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.com

Sondazhi i ditës:
13 Mars, 08:44
Zgjedhjet e 11 majit, cila listë e kandidatëve iu bind më shumë?

PS | PD | Partitë e vogla

Lajme të tjera

Zbulohen emrat e kandidatëve për deputetë në listat e mbyllura të PD në qarqet Lezhë e Berat
12 Mars, 18:33

Kishte kryer disa vjedhje në Milano, arrestohet 33-vjeçari nga Laçi, pritet ekstradimi në Itali (EMRI+VIDEO)
12 Mars, 08:52

Menaxhimi i plazheve publike hap debat në Lezhë, PD: Shoqëria e krijuar nga bashkia abuzim me çmimet! Ndreu: Akses i lirë për qytetarët
Elvis Hila
11 Mars, 16:17

Rama ndjek punimet në aksin Rrilë-Hidrovor: Pjesë e projekteve për zhvillimin e turizmit në Tale
10 Mars, 22:57

Motori përplaset me kamionin në aksin Lezhë-Shkodër, ndërron jetë në spital 51-vjeçari (EMRI)
10 Mars, 21:20

'Jam me Trump', Rama batuta edhe me banorët: Hajde pak ti me atë kapelën se më mbyte fare! Inspekton kantierin e rrugës Rrile-Hidrovor (VIDEO)
10 Mars, 17:39

Lezhë/ Një rrugë e drejtë, 2 kilometra që të çon në plazh nuk asfaltohet, banorët: Na mashtrojnë për fushatë por asgjë nuk bëjnë
Elvis Hila
10 Mars, 15:56

Lezhë/ Aksident në aksin Kune-Shëngjin, përplasen dy motorë! 1 i plagosur, transportohet në spital
9 Mars, 15:32

Aksident i trefishtë në aksin Lezhë-Shkodër pranë fshatit Kakarriq, plagoset një grua (VIDEO)
9 Mars, 12:10

Lezhë, përplasi për vdekje ish-kunatin, Apeli lë në fuqi dënimin me 30 vite burg për Albert Kacajn
Elvis Hila
9 Mars, 09:26

'Work and study', maturantët e Lezhës njihen me ofertat e universiteteve publike e private, Gjura: Do çelen degë të reja në Universitetin e Shkodrës
Elvis Hila
8 Mars, 16:42

Folklori shqiptar përmes ngjyrave, piktori nga Kosova, Xhevdet Spahia çel ekspozitë në Lezhë
Elvis Hila
8 Mars, 16:33

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje